Kronikë

Plagoset efektivi i FNSH-së në Tiranë, policia: E qëlloi gabimisht kolegu gjatë përgatitjes për stërvitje! Pezullohet nga detyra

Një efektiv i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë është plagosur aksidentalisht dje në mesditë (15 shkurt) nga një koleg i tij gjatë përgatitjes për stërvitje brenda repartit të FNSH-së. Megjithëse fillimisht u raportua si vetëplagosje, policia sqaroi sot se inspektori K.Ç, ka plagosur në këmbë inspektorin Xh.L



Foto ilustruese

Redaksia
16 Shkurt, 09:03 | **Përditësimi: 16 Shkurt, 10:22**

Share

TIRANË- Një efektiv i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë është plagosur aksidentalisht dje në mesditë (15 shkurt) nga një koleg i tij gjatë përgatitjes për stërvitje brenda repartit të FNSH-së. Megjithëse fillimisht u raportua si vetëplagosje, policia sqaroi sot se inspektori Konstandin Çipi dyshohet nga pakujdesia i ka shkrepur arma e shërbimit dhe për pasojë ka plagosur në këmbë inspektorin Xhojsi Lamaj, i cili ndodhet në spital, jashtë rrezikut për jetën.

Ndërsa punonjësi i Policisë Konstandin Çipi është pezulluar nga detyra.

> *'Më datë 15.02.2024, rreth orës 12:40, në ambientet e Njësisë së Sigurisë Publike Tiranë, punonjësi i Policisë Inspektor K. Ç., gjatë përgatitjes për stërvitje, dyshohet se nga pakujdesia i ka shkrepur arma e shërbimit dhe për pasojë është plagosur në këmbë, punonjësi i Policisë Inspektor Xh. L., i cili ndodhet në spital, jashtë rrezikut për jetën. Ndërsa punonjësi i Policisë K. Ç. është pezulluar nga detyra.*



LEXO EDHE:
Tiranë/ Mbante pistoletë dhe jelek antiplumb në banesë, në pranga 62-vjeçari (EMRI)

Menjëherë është ngritur grupi hetimor në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe veprimet procedurale për këtë rast po kryhen nga AMP.

Drejtoria e Standardeve Profesionale ka filluar një hetim të thelluar administrativ për mosrespektimin e procedurave standarde për mbajtjen dhe administrimin e armëve të brezit, nga punonjësit e Policisë.

Në përfundim të këtyre veprimeve, Prokuroria, Policia Gjyqësore dhe AMP kanë nisur procedimin penal në gjendje të lirë, për punonjësin e Policisë K. Ç., për plagosje nga pakujdesia.'- njofton policia.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: fnsh Tirane plagosje

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Duhet të rihetohet Berisha për kryengritjen e armatosur të 14 shtatorit '98?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Mero Baze: SHBA 'ndau' Shqipërinë nga Kosova

Mero Baze

15 Shkurt, 22:42

FOTOLAJM/ 'Mirupafshim Shqipëri', momenti kur Blinken largohet nga aeroporti 'Nënë Tereza'

15 Shkurt, 20:47

Ylli Pata: Pse opozita s'pati aqjendë te Blinken?

Ylli Pata

15 Shkurt, 20:43

E PLOTË/ Vizita historike në Tiranë, Blinken nga Piramida: SHBA-Shqipëri do ta bëjnë botën më të sigurtë dhe më të qëndrueshme

Antony Blinken

15 Shkurt, 19:36

'Jemi me fat që kemi SHBA-të', si e komentojnë qytetarët vizitën e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Tiranë

15 Shkurt, 18:43

Blinken në Tiranë, takim 110 minuta me Ramën: Anëtarët e krimit të organizuar të përfundojnë në gjyq! Kryeministri: Rrëzuam mitin e pandëshkueshmërisë

15 Shkurt, 17:40

Tiranë/ Po shkëmbenin drogë, droni i policisë 'kap' në flagrancë dy vëllezërit në Allias (EMRAT)

15 Shkurt, 10:48

Blinken sot në Tiranë, masa të rrepta sigurie! Ja rrugët ku ndalohet qarkullimi

15 Shkurt, 07:17

Studiues e diplomatë komentojnë vizitën e Sekretarit Amerikan, Blinken, në Shqipëri: Dëshmon angazhim të madh në gadishullin ballkanik

14 Shkurt, 19:50

VIDEO/ Abuzoi seksualisht me të miturën në Tiranë, arrestohet 31 vjeçari! Ngjarja u mësua kur vajza u paraqit në spital

14 Shkurt, 16:15

Si festohet Shën Valentini në Tiranë, nga dhuratat te udhëtimet! Historia e çiftit Xhagjika, 40 vite të martuar: Gjithçka nisi te Pallati i Kulturës

Ledina Jakimi

14 Shkurt, 16:15

'Komisar Katani' me libër për shqiptarët, Monforte: Erdha këtu në 2006-ën, rrugët ishin me puseta, lagjja pa ujë e drita! Tani ndihem si në shtëpi

Anila Dedaj

14 Shkurt, 16:03

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje